



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK
NJËSIA PROKURIMIT

Data 19/06/2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM I MIRËMBAJTJES SË STACIONAREVE TË AJRIT ”
MK për 12 muaj**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 98390000-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,162,400 (pesëmilionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e katërqind) leke pa TVSh

Shumatorja e çmimeve për njësi/ per një sasi është 186,250 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Instituti i Shëndetit Publik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi:Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, i ndryshuarnë të cilën është e parashikuar se:

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b. Lista e çmimeve të shërbimit, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9:

Argumentimi: Ky kriter u vendos në mbështetje të nenit 76 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se:

"1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla."
Ky kriter i siguron AK që operatori ekonomik nuk ka detyrime ndaj Institucioneve Shtetërore (taksa, tatime, oshe, etj, si dhe çdo detyrim tjetër të parashikuar në shtojcës 8 të DST) duke e siguruar Autoritetin Kontraktor që Operatori ekonomik, do ta realizojë kontratën me sukses.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë). (**nuk është e aplikueshme**)

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2020 ,2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20%

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti OE duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të kërkuara.

*Shënim**: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar, për të cilën ofertohet, konkretisht

5,162,400 *20% =1,032,480 (njemilion e tridhjetë e dymijë e katërqind e tetëdhjetë) Lek

Kur konkurohet për vlera mesatare do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës është kryer brenda kufirit të vlerës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues, nëpërmjet xhiros së realizuar në një nga tre vitet e kërkuara. Është e rëndësishme që ofertuesi, përpara se të dorëzojë ofertën duhet të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin, mundësinë e likuiditeteve të nevojshëm për ekzekutimin e suksesshëm të kontratës, dhe të sigurojë AK që ka stabilitetin e nevojshëm për të kryer më sukses kontratën AK ka parashikuar vlerën jo më të vogël se 20 %, në zbatim të limiteve të vendosura nga VKM-ja nr 285 datë 19.05.2021, në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen e sa më shumë OE-ve të cilat kanë eksperiencën e nevojshme duke siguruar AK për kryerjen me sukses kontratën në rastin e shpalljes fitues, dhe ky kriter, është në përputhje me natyrën, vlerën e objektit të kontratës

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ i ndryshuar ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi **deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;si dhe nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohet*Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhës.***

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të (*shëno bazën ligjore*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(*Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor*) **(nuk është e aplikueshme)**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, _____(*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese*). **(nuk është e aplikueshme)**

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se **15 % të vlerës së fondit të limit të përlogaritur**.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, jo më të vogël se **15 %** do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar, për të cilën ofertohet, **konkretisht**

5,162,400 *15% =774,360 (shtatëqind e shtatëdhjetëmijë e treqind e gjashtëdhjetë) Lekë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 15 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben autoritetit kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet vlerën jo më të vogël se 15% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore/polisa sigurimi për ta provuar kryerjen e tyre, qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

AK ka parashikuar një vlerë jo më të vogël se 15 % në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen e sa më shumë OE-ve të cilat kanë eksperiencën e nevojshme dhe stabilitetin e nevojshëm për të kryer me sukses kontratën në rastin e shpalljes fitues, duke qenë se objekti i kontratës është specifik, dhe është në përputhje me natyrën, vlerën e objektit të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i paisur me certifikatë ISO 9001:2015 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, të vlefshme. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79/1, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) dhe nenit 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë.

Argumentimi kësaj kërkesë lidhet ngushtë me objektin e kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikatat e cilësisë se nevojshme dhe operojnë sipas standarteve të cilësisë për të realizuar kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente, duke siguruar AK që këto shërbime do të kryhen sipas standarteve

Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. *Dokumenti duhet të jetë origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave*, si dhe duhet të plotësohen nga secili prej anëtarëve në rast të ofertës nga bashkim operatorësh.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të jetë i paisur me Certificate ISO 45001:2018 për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (e vlefshme) /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79/1, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) dhe nenit 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë.

Argumentimi kësaj kërkesë lidhet ngushtë me objektin e kontratës.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikatat e cilesisë se nevojshme dhe operojnë sipas standarteve të cilësisë për të realizuar kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente, duke siguruar AK që këto shërbime do të kryhen sipas standarteve

Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. *Dokumenti duhet të jetë origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave*, si dhe duhet të plotësohen nga secili prej anëtarëve në rast të ofertës nga bashkim operatorësh.

2.3.4. * Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

Numri	Pozicioni
2 (dy)	Inxhinier në profilet elektrik, ose elektronik, ose telekomunikacion ose inxhinieri informatike, ku te pakten njeri te jete me diplome te profilit elektrik ose elektronik.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- a. Diplomën e personelit, nëse është rasti të njësuar në MASR (për diplomat e marra jashtë vendit), origjinale ose njësi me origjinalin e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit .
- b. Të paktën një nga stafi të paraqesi Certifikatë Trajnimi për mirembajtjen dhe kalibrimin e paisjeve te monitorimit te cilesise se ajrit Urban/ ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.
Dokumentat duhet te jene origjinale ose njësi me origjinalin e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit .
- c. Kontratë pune / shërbimi e vlefshme në momentin e këtij prokurimi

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.**

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i paridorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për stafin teknik është bërë në përputhje me specifikimet teknike dhe nevojës për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtje së stacionareve të ajrit të Institutit të Shëndetit Publik.

Kjo kërkesë lidhet ngushtë me objektin e kontratës. AK nëpërmjet kësaj kërkesë sigurohet që OE ka stafin e nevojshëm të kualifikuar për të kryer shërbimin objekt të kësaj kontrate në stafin e operatorit ekonomik, të cilët njohin paisjet, dhe kanë njohuritë e duhura për këto paisje.

Argumentimi teknik per dy inxhinier: meqenese jane 2 (dy) qendrat stacionare të ajrit si dhe 4 (katër) njësitë e transportueshme të ajrit referuar zbatimit përkatës konsiderohen të rëndësishme në institucion dhe për këtë kërkohet një suport i mirëfilltë përgjatë periudhës së mirëmbajtjes apo në raste problematikash / defektesh të mundshme në të ardhmen drejt garantimit të aksesueshmërisë, funksionaliteteve dhe sigurisë në aplikim. Prania e 2 (dy) inxhinierëve do të favorizonte në kohë dhe cilësi, suportin e vazhdueshëm, zëvendësimin e komponentëve / njësisive modulare apo pajisjeve të këmbimit duke përbushur aktivitetet ‘multitasking’, si dhe asistencen në ndërhyrjet korrigjuese, parandaluese si dhe testimin të vazhduar, në paralel referuar pajisjeve përkatëse duke ofruar zgjidhjen e problematikave dhe garantuar 'feedback', aksesueshmëri, funksionalitete dhe siguri në lidhje me pajisjet e synuara mjekësore. Gjithashtu prania e 2 (dy) inxhinierëve do të shërbejë edhe si një alternativë rezervë duke mundësuar zëvendësimin e njëri-tjetrit (në raste sëmundjesh / fatkeqësish) duke garantuar ofrimin e shërbimit si dhe vijimin e aktivitetit të mirëmbajtjes brenda afatit kohor të caktuar në procedure, si dhe do të siguronte më tej përbushjen me sukses të aktiviteteve si instalime / konfigurime / parametrizime / ndërhyrjeve riparuese / testime drejt një suporti preciz përgjatë periudhës së mirëmbajtjes.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht -- persona**. Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. *-(nuk është e aplikueshme)*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën. *-(nuk është e aplikueshme)*

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

.....
.....

(Shënim- Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës së shërbimit, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer). (nuk është e aplikueshme)

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

.....
.....
Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. *-(nuk është e aplikueshme)*

.....
.....
(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:). (nuk është e aplikueshme)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Kjo fjali është marrë identike si shfaqet edhe në modelet e “Dokumentet Standarde të Tenderit”, që gjenden në faqen e APP-së, për procedurat e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”)

➤ **Specifikimet teknike**

Argumentimi i Specifikimet teknike

Specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi janë përcaktuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor, si më poshtë vijon:

Shërbimi që duhet të ofrohet: **Mirëmbajtja e paisjeve të Stacionareve të Ajrit full risk**, për të gjitha modulet e stacionareve automatike dhe gjysemautomatike (Tecora), duke siguruar transmetimin e të dhenave të paisjeve në kohë reale, si më poshtë:

I. Shërbim mirëmbajtje të paisjeve stacionare të ajrit (automatike) (2 njësi) (shërbim full risk)

Qëndrat e pajisjeve stacionare ndodhen: 1 (një) qendër stacionare e ajrit në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP) dhe 1 (një) qendër stacionare e ajrit në Poliklinikën e Specialiteteve nr.3 (Tiranë) dhe kompozohen nga modulet kryesore si vijon

1. Moduli Analizatori i PM10/PM2.5 (Grimm Aerosol Teknik, Model 180)
2. Moduli Analizatori i SO₂ (Teledyne Instrument Model 100E)
3. Moduli Analizatori i NO_x (NO/NO₂, Teledyne Instrument Model 200E)
4. Moduli Analizatori i CO (Teledyne Instrument Model 300E)
5. Moduli Analizatori i O₃ (Teledyne Instrument Model 400E)
6. Moduli Analizatori i BTEX (GC 955, bombola e azotit)
7. Moduli i sistemit të kalibrimit për O₃ (Teledyn model 703E Teledyn)+Moduli parametrizimit dhe precizionin të paisjeve (Teledyn model 702E) . Set për secilën paisje
8. Sistemi i transmetimit të të dhenave (router / switch / kabuj dhe konektorë, pajisje rrjeti ekuivalente, njësi kompjuterike, software / platformë aksesimi / aplikacion, llogari përdoruesi për akses)
9. Kabina e stacionit (rrjeti elektrik, kondicioneri, UPS, kabina fizike)

Në lidhje me mirëmbajtjen “full risk” të njësisve stacionare të ajrit, duhet të zbatohen dhe të respektohen udhëzimet / sugjerimet / instruksionet e mirëmbajtjes sipas prodhuesit apo distributorit të autorizuar si vijon:

1. Moduli Analizatori i PM10/PM2.5 (Grimm Aerosol Teknik, Model 180)
Llojet e shërbimeve të mirembajtjes
Pastrim i tubit të prurjes së ajrit brenda monitorit
Pastrim i xhamit në hyrje të tubit të mostrimit
Pastrim i tubit të mostrimit
Nderrim i filtrit BQ
Nderrim i filtrit CQ

Pastrim i kutise prej celiku
Pastrim i filtrit te brendshem
Pastrimi i kokes se mostrimit
Garantim i funksionimit te pompes se thithjes
Çdo shërbim tjetër i paparashikuar që mund të ndodhe

2.Moduli Analizatori i SO ₂ (Teledyne Instrument Model 100E)
Llojet e shërbimeve të mirembajtjes
Nderrimi i filtrave PTFE
Verifikim i testit te funksionimit
Kontrolli i zeros dhe spanit
Kalibrimi ne zero dhe span
Kontrolli i flow
Kontrolli i rrjedhjes ne sistemin pneumatik
Riparim i diafragmes se pompes
Kalibrim i llampes UV
Nderrimi i llampes UV
Kalibrim hardëare i sensorit PMT
Pastrim i dhomes optike dhe filtrave
Nderrim i setit te unazave
Garantim i funksionimit te sensorit te presionit dhe flow
Garantim i funksionimit te bllokut te ushqimit 15Vdhe 12V
Nderrim i orificeve 012 mil
Nderrim i filtrit te mbetjeve (sintered)
Cdo shërbim tjetër i paparashikuar në listë

3- Moduli Analizatori i NO _x (NO/NO ₂ , Teledyne Instrument Model 200E)
Llojet e shërbimeve të mirembajtjes
Verifikim i testit të funksionimit
Nderrimi i filtrit PTFE
Kontrolli i zeros dhe spanit
Kalibrimi
Nderrimi i kimikateve tek filtri i Ozonit
Pastrim i dhomes së reaktorit
Nderrim i filtrit DFU
Kontroll i rrjedhjes në rrugën e kalimit të gazit të sistemit pneumatik
Nderrimi i setit të unazave
Kalibrimi hardëare i sensorit PMT
Garantimi i funksionimit të pompës së mostrimit
Nderrimi i Filtrit në hyrje të pompës së jashtme të modulit
Garantim i efikasitetit të konverterit të NO ₂
Garantim i funksionimit të sensorit të presionit dhe flow
Garantim i funksionimit të bllokut të ushqimit 15V dhe 12V
Nderrim i orificeve 4mil dhe 10mil
Nderrim i filtrit të mbetjeve (sintered)
Cdo shërbim tjetër i paparashikuar në listë

4- Moduli Analizatori i CO (Teledyne Instrument Model 300E)
Llojet e shërbimeve të mirembajtjes
Nderrim i filtrave PTFE

Riparim i diafragmes se pompes
Verifikimi i testit te funksionimit
Kontrolli i floë
Kontrolli i rrjedhjes
Kontrolli dhe pastrimi i sistemit pneumatik
Pastrim i jashtem i pajisjes
Kontrolli i zero/Span
Kalibrimi
Kontroll i burimit IR
Nderrimi i setit te unazave
Garantim i funksionimit te sensorit te presionit dhe flow
Garantim i funksionimit te bllokut te ushqimit 15Vdhe 12V
Nderrim i orificeve 10 mil dhe 13 mil
Nderrim i filtrit te mbetjeve (sintered)
Cdo shërbim tjetër i paparashikuar në listë

5- Moduli Analizatori i O ₃ (Teledyne Instrument Model 400E)
Llojet e shërbimeve të mirembajtjes
Nderrimi i filtrit PTFE
Pastrimi nga pluhurat i tubit te absorbimit
Riparimi i diafragmes se pompes
Verifikimi i testit te funksionimit
Filter pastrues i O ₃ standard
Kontrolli i flow
Kontrolli i rrjedhjes

Kontrolli dhe pastrimi i sistemit pneumatik
Kontrolli i zero/span
Kalibrimi
Pershtatja e Llampes UV
Nderrimi i llampes UV
Nderrimi i setit te unazave
Garantim i funksionimit te sensorit te presionit dhe flow
Garantim i funksionimit te bllokut te ushqimit 15Vdhe 12V
Nderrim i orificeve 13 mil
Nderrim i filtrit te mbetjeve (sintered)
Cdo shërbim tjetër i paparashikuar në listë

6- Moduli Analizatori i BTEX (GC 955, bombola e azotit)
Llojet e shërbimeve të mirembajtjes
Kontrolli ne Span
Kalibrimi
Nderrimi i filtrit PTFE
Pastrim i ventilatorit
Pastrim i llampes
Pastrim i PID
Nderrim i filtrit te brendshem
Pastrim i diafragmes
Nderrim i tubit te jashtem te mostrimit
Zevendesim i tubit tenax (Preconcentration tube)
Optimizim i harddiskut

Pastrim i tubit te brendshem te gazit
Pastrim i mbajteses dhe nderrimi i setit te unazave te llampes
Cdo shërbim tjetër i paparashikuar në listë

7- Moduli i sistemit te kalibrimit për O3 (Teledyn model 703E Teledyn)+Moduli parametrizimit dhe precizionin te paisjeve (Teledyn model 702E) . Set per seicilën paisje
Llojet e shërbimeve të mirembajtjes
Nderrimi i substancave absorbuese
Kontroll i sistemit te kalibrimit(reduktor, bombula, kalibrator, kompresor)
Nderrimi i filtrit DFU ne hyrje
Cdo shërbim tjetër i paparashikuar në listë

8-Sistemi i transmetimit te te dhenave (router / switch / kabuj dhe konektorë, pajisje rrjeti ekuivalente, njësi kompjuterike, software / platformë aksesimi / aplikacion, llogari përdoruesi për akses)
Llojet e shërbimeve të mirembajtjes
Garantim i funksionimit te sistemit te transmetimit gjatë gjithë vitit
Asistencë drejt zgjidhjes së problemeve të aksesimit, aplikimit të platformës si dhe garantim të kredencialeve / llogarive të përdoruesave dhe licencave (nëse aplikohen) drejt aksesimit dhe aplikimit të platformës së shërbimit.

Cdo shërbim tjetër i paparashikuar në listë

9- Kabina e stacionit (rrjeti elektrik, kondicioneri, UPS, kabina fizike)
Llojet e shërbimeve të mirembajtjes
Garantim i funksionimit te sistemit elektrik
Garantim i funksionimit te UPS dhe Bativerive
Pastrimi i filtrit te kondicionerit
Garantim i funksionimit te kondicionerit
Lyerja e kabines me boje

Pastrim i ambjentit te brendshem te kabines
Sherbim dhe nderrim i braves se stacionit
Cdo shërbim tjetër i paparashikuar në listë

Operatori Ekonomik i kontraktuar fillimisht duhet të kryej proceset ekazminuese, testuese dhe nëse është rasti dhe ndërhyrjen për riparimin dhe rikthimin e njësisve stacionare të ajrit në kushte funksionale drejt aplikimit të tyre duke garantuar siguri, funksionalitete, aplikueshmëri dhe aksesueshmëri (full risk)

Mirëmbajtja parandaluese: ky shërbim duhet të kryhet për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e pajisjeve të **Stacionareve të Ajrit** dhe pjesëve përbërëse të saj, për të ruajtur sistemin e pajisjeve në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjes.

Mirëmbajtja korrigjuese: Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, identifikimin e shkaqeve, eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe kontrollin e sigurisë. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimit të komponentëve të stacioneve të ajrit.

Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korrigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së pajisjes, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontrolleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, i Kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek Kontraktuesi.

Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha mos konformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç verifikimeve dhe shërbimeve periodike, shërbimi i verifikimit të sigurisë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.

Kryerja e shërbimeve dhe mirëmbajtja e **pajisjeve stacionare automatike**, përveç shërbimeve sa më lartë përfshin blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit, përdorimit, materialet e konsumit etj., gjatë kryerjes së shërbimeve me shpenzimet e Operatorit Ekonomik sipas shërbimit **full risk**. Materialet dhe pjesët e këmbimit, materialet e konsumit et duhet të jenë të reja, origjinale/ ose ekuivalente me origjinalin dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje . Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimin

II. Shërbim mirëmbajtje të paisjeve stacionare gjysmë automatike të transportueshme të ajrit, pozicionohen sipas interesit të aplikimit (kryesisht ISHP) dhe janë me prodhues TECORA(Tecora– Charlie/HV Sentinel PM Skypost Pm/HV) per matjen e PM 10/PM2.5 .(4 copë)- (shërbim full risk)

Në lidhje me mirëmbajtjen “full risk” të njërive të transportueshme të ajrit, duhet të zbatohen dhe të respektohen udhëzimet / sugjerimet / instruksionet e mirëmbajtjes sipas prodhuesit apo distributorit të autorizuar si vijon:

Llojet e Mirembajtjes dhe shërbimeve
Kontrolli i pompes standarde
Kontrolli dhe kalibrimi i sensorit te temperatures dhe presionit
Kontrolli i shpejtesise se fluksit dhe test i rrjedhjes
Nderrimi i gazmetrit
Kontrolli i gazmetrit me koeficientin e korrjgimit
Nderrimi i rondeles O-ring ne linjen e mostrimit
Ndryshimi i filtrit mbrojtës te pluhurave
Kontrolli testeve funksionale
Nderrimi i filtrit mbrojtës te brendshem te bllokut te pompes
Filtrat e marrjes se kampionit (te pakten 16 cope filtra/muaj per seicilen)
Cdo shërbim tjetër të paparishikuar në këtë listë

Operatori Ekonomik i kontraktuar fillimisht duhet të kryej proceset ekazminuese, testuese dhe nëse është rasti dhe ndërhyrjen për riparimin dhe rikthimin e njërive të transportueshme të ajrit në kushte funksionale drejt aplikimit të tyre duke garantuar siguri, funksionalitete, aplikueshmëri dhe aksesueshmëri.(full risk)

Mirëmbajtja parandaluese: ky shërbim duhet të kryhet për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e pajisjeve *gjysmë automatike të ajrit* dhe pjesëve përbërëse të saj, për të ruajtur sistemin e pajisjeve në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjes.

Mirëmbajtja korrigjuese: Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, identifikimin e shkaqeve, eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe kontrollin e sigurisë. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimin e komponentëve të stacioneve gjysmë automatike të ajrit.

Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korrigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së paisjes, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me

çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontrolleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, i Kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek Kontraktuesi.

Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha mos konformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç verifikimeve dhe shërbimeve periodike, shërbimi i verifikimit të sigurisë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime, përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta.

Katër stacionet gjysmë automatike të transportueshme të ajrit model TECORA, pozicionohen sipas interesit të kontraktuesit (ISHP).

Kryerja e shërbimeve dhe mirëmbajtja e **pajisjeve gjysmë automatike**, përveç shërbimeve sa më lartë përfshin blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit, përdorimit, materialet e konsumit etj., gjatë kryerjes së shërbimeve me shpenzimet e Operatorit Ekonomik sipas shërbimit full risk. Materialet dhe pjesët e këmbimit, materialet e konsumit etj, duhet të jenë të reja, origjinale/ ose ekuivalente me origjinalin dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit

Orari dhe vendet e kryerjes së shërbimeve për të gjitha pajisjet

Personeli teknik i të Kontraktuarit do të garantojnë mbulimin e shërbimit për një periudhë 12 mujore me lidhjen e kontratës, me përjashtim të festave zyrtare, nga e hëna në të premte me orë 08:00-16:30. Këto mund të jenë objekt ndryshimesh në varësi të nevojave specifike të Kontraktuesit.

I Kontraktuari do të sigurojë realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në kontratë edhe në rast greve apo konfliktesh sindikaliste apo ngjarje të tjera të parashikueshme.

I Kontraktuari do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera.

Njoftimi për defektet do të kryhet me telefon ose/dhe email.

Kohëzgjatja maksimale e ndërhyrjes dhe riparimit të defektit (për cdo lloj pajisje) do të jetë jo më shumë se 24-48 orë, pranë vendndodhjes së saj, kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe 30 ditë pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.

Argumentimi : Përcaktimi specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, janë, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, dhe janë hartuar nga grupi i punës së përlllogaritjes së fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike.

Shërbimet dhe mirëmbajtjen e nevojshme për stacionaret është e domosdoshme të jete full risk, për të gjitha modulet e stacionareve automatike dhe gjysem automatike (Tecora), sepse është e pamundur që të

përcaktohet saktësisht llojin i difektit si do të ketë, në c’kohë do të ndodhë, dhe rëndësia e këtij difekti . Kjo siguron AK për cilësinë dhe vazhdimësinë e monitorimit të tyre gjatë gjithë periudhës 12 mujore .

➤ **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

Shërbimet që kërkohen:

Shërbimi (ful risk), -Mirembajtja e stacionareve automatike dhe gjysëm automatike te monitorimit te ajrit

Nr	Përshkrimi i shërbimeve	Sasia e paisjeve	Sasia/ Muaj	Grafiku i ekzekutimit
I	Mirëmbajtja e stacionit automatik ne ISHP dhe poliambulatorja ne Tiranë	2	12	<i>Afati do te jete 12 muaj, duke filluar nga nenshkrimi i marreveshjes kuader (Sipas specifikimeve)</i>
II	Stacione paisje monitorimi të plhurave TECORA (Tecora – Charlie/HV Sentinel PM Skypost Pm/HV) per matjen e PM 10/PM2	4	12	

Shërbimet do të jenë full risk për paisjet automatike dhe gjysëm automatike, të cilat duhet të jenë funksionale

Afatet e ekzekutimit: *Afati i ekzekutimit për objektin “Shërbim i Mirëmbajtjes së Stacionareve automatike dhe gjysëm automatike te monitorimit te ajrit”, do të jetë 12 muaj duke filluar nga momenti i nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër me Operatorin Ekonomik të Suksesshëm.*

Argumentimi: Sasia dhe Grafiku i levrimit janë vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 41 të VKM-së Nr. 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, e cila ndihmon AK për të siguruar në kohë shërbimin dhe sasinë e kërkuar nga OE, si dhe i jep mundësinë OE të planifikojë ofertën mbi bazën e kërkesave të AK

➤ **TERMAT E REFERENCES**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Mirembajtja e stacionareve automatike të ajrit, dhe mirembajtja dhe shërbimet stacioneve gjysem automatike të monitorimit të pluhurave Tecora, të përshkruara në **Shtojcën nr.6**. Shërbimet dhe mirembajtjen e nevojshme për stacionaret është e domosdoshme të jetë full risk, për të gjitha modulet e stacionareve automatike dhe gjysem automatike (Tecora).

Detyrat: OE_ duhet të kryejë Shërbimet dhe mirembajtjen e nevojshme për stacionaret është e domosdoshme të jetë (full risk), për të gjitha modulet e stacionareve automatike dhe gjysem automatike (Tecora), duke siguruar transmetimin e të dhënave të paisjeve duke zbatuar edhe specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5.

Shpërndarja: Një stacionare automatike e ajrit është në ISHP dhe një është tek Poliklinika nr.3 në Tiranë. Ndërsa stacionaret paisjet gjysem automatike për monitorimit të pluhurave Tecora do të jenë në ISHP, ose në rrethet ku do të stacionohen gjatë monitorimit.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: **Instituti i Shëndetit Publik, ose pranë vendit ku ndodhet Paisja/et**

Argumentimi: Termat e Referencës janë vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 41 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, e cila ndihmon AK për të siguruar në kohë shërbimin dhe sasinë e kërkuar nga OE, si dhe i jep mundësinë OE të planifikojë ofertën mbi bazën e kërkesave të AK

* * *

Për sa më sipër, anëtarët e Njesisë së Prokurimit miratojnë nëpërmjet këtij procesverballi kriteret e mësipërme të kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë. Njësia e Prokurimit do t'i pasqyrojë ato në Dokumentet Standarde të Tenderit të kësaj procedure, dhe së bashku me DST, procesverballi do të ngarkohet në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Personi i autorizuar i Njesisë së Prokurimit për kryerjen e veprimeve në SPE caktohet Lindita Kokona e cila do të vijojë me dërgimin e dokumenteve të tenderit për publikim dhe hedhjen në sistem të dokumentacionit që kërkohet.

* * *

Pasi lexohet, procesverballi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

- **Liljana Hoxha** - Specialist fushë Sektori Epidimiologjisë Ambientale dhe Kontrollit të Cilësisë së Ajrit
- **Aldo Qevjani** - Specialist i fushës, Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore
- **Lindita Kokona** Person Përgjegjës për Prokurimet